

L I G J
Nr.8536, datë 18.10.1999

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË KODIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 499 shtohet paragrafi i tretë, me këtë përmbajtje:

“Dispozitat për kalimin e kredisë nuk zbatohen ndaj kredive që lidhen me transaksione financiare, ndaj të cilave janë vendosur barrë siguroese, sipas kriterëve të përcaktuara me ligj të veçantë.”

Neni 2

Në nenin 546 shtohet një paragraf i dytë, me këtë përmbajtje:

“Dispozitat për pengun nuk zbatohen ndaj kredive që lidhen me transaksione financiare, ndaj të cilave janë vendosur barrë siguroese, sipas kriterëve të përcaktuara me ligj të veçantë.”

Neni 3

Neni 605 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 605

Radha e preferimit

Paguhet me preferim, sipas radhitjes së tyre kreditë e mëposhtme:

- a. kreditë që rrjedhin nga transaksionet financiare të siguruara me barrë siguroese për çmimin e blerjes së një objekti të veçantë;
- b. kreditë që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim, por jo më shumë se për 12 muaj;
- c. kreditë e sigurimeve shoqërore për kontributet e papaguara së bashku me kamatat, si dhe kreditë e punonjësve për dëmet e pësuar nga mospagimi prej punëdhënësit të kontributeve të mësipërme;
- ç. kreditë që rrjedhin nga shpërblime për shkak vdekjeje e dëmtimi të shëndetit;
- d. kreditë e autorëve dhe të trashëgimtarëve të tyre për shpërblimet që rrjedhin nga tjetërsimi i plotë ose i pjesshëm i të drejtave të tyre në fushën intelektuale për detyrimet e lindura gjatë dy vjetëve të fundit;
- dh. kreditë e shtetit, që rrjedhin nga detyrimet ndaj buxhetit dhe kreditë e institutit të sigurimeve shtetërore për sigurimet e detyrueshme, të përcaktuara me ligj;
- e. kreditë, që rrjedhin nga transaksionet financiare, të siguruara me barrë siguroese, sipas kriterëve të përcaktuara me ligj;
- ë. kreditë, që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim tej kufirit të caktuar në shkronjën “b” të këtij neni;
- f. shpërblimi i ndërmjetësimit që rrjedh nga kontrata e agjencisë, kur ai rrjedh gjatë vitit të

fundit të shpërblimit;

g. kreditë e siguruara me hipotekë ose me peng që nuk krijojnë barrë siguruese, sipas ligjit, nga vlefte e sendeve në hipotekë ose të lëna peng;

gj. kreditë që rrjedhin nga shpenzimet e gjyqit për ruajtjen e sendit dhe ato për veprime ekzekutive, të bëra në interesin e përbashkët të kreditorëve, nga vlefte e shitjes së sendeve;

h. kreditë e dhëna nga bankat, të cilat nuk përfshihen në shkronjën “e” dhe kreditë që rrjedhin nga sigurimet vullnetare;

i. kreditë për furnizimin me farëra, plehëra kimike, insekticide, ujë për ujitje dhe për punimet e kultivimit e të mbledhjes së prodhimeve bujqësore, mbi prodhimin (frutet) bujqësor të vitit, për të cilin janë përdorur kreditë.

Kur ka disa kredi sipas shkronjës “a” dhe shkronjës “e” të këtij neni, rradha e preferimit përcaktohet sipas kritereve të përcaktuara me ligj të veçantë. Kur ligji i veçantë nuk i jep një kredie sipas shkronjës “a” preferim mbi kreditë sipas shkronjës “e”, kredia sipas shkronjës “a” do të preferohet sipas shkronjës “e”.

Përfshihen nga rradha e preferimit sipas këtij neni kreditë sipas shkronjës “e”, që janë dhënë aktualisht, të cilat do të preferohen përpara kredive sipas shkronjës “dh” në rastet që vijnë:

- kredia sipas shkronjës “e” është regjistruar sipas ligjit, ndërsa kredia sipas shkronjës “dh” nuk është regjistruar,

- kredia sipas shkronjës “e” është regjistruar sipas ligjit, përpara regjistrimit të kredisë sipas shkronjës “dh”.

Neni 4

Pas nenit 749 shtohet neni 749/a me këtë përmbajtje:

“Rregullat e parashikuara nga nenet 746, 747, 748 dhe 749 nuk zbatohen për shitjet me rezervë të pronës, lidhur me transaksione financiare me barrë siguruese, për të cilat zbatohen rregullat e përcaktuara me ligj të veçantë.”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2467, datë 28.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**